



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ prot.

Himarë, më ____ . ____ . 2026

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës – Sherbim

PËR ARGUMENTIMIN E REALIZIMIT TË PROCEDURËS NË NJË KONTRATË

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Projekte zbatimi (blerje projektesh)”

Lloji i procedurës së prokurimit: E hapur, mbi kufirin e lart monetar (sherbime), (Marrëveshje kuadër me disa operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara)

Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): projekte 22114311-5 ; Sherbime per projektme teknike per ndertimin e veprave ne inxhinierine e ndertimit 71322000-1; Sherbime per projektim te arkitektures 71220000-6 ; Sherbim per projektim ndertesash 71221000-3

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 50,000,000 (pesëdhjetë milione) pa tvsh Ose 523,780 (Pesëqind e njëzet e tre mijë e shtatëqind e tetëdhjetë euro) pa TVSH me kursin e datës 13.05.2026 të BSH me vlerë 1 euro= 95.46 leke)

Argumentimi në lidhje me Nenin 39, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, për mos ndarjen në lote të procedurës së prokurimit:

Arsyeja kryesore e mosndarjes së procedurës së prokurimit në lote është se referuar natyrës së shërbimit, specifikimeve teknike, kemi të bëjmë me një artikull të vetëm “**Projekte zbatimi (blerje projektesh)**”. Vetë natyra e kontratës, marrëveshje kuadër me shumë operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, tregon se sasia e shërbimit është e papërcaktuar dhe varion në varësi të nevojave të AK. Vetë kërkesat janë në varësi të ecurisë së proceseve të tjera të pa lidhura me këtë kontratë dhe si të tilla nuk mund të kushtëzohen në ndarej me lote.

Nga ana tjetër referuar Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 2 prashikohet shprehimisht se: “*Qëllimi i këtij ligji është:*

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Në kreun V, Neni 42, pikat 1 dhe 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, parashikohet shprehimisht:

1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.

2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale. Referuar Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 14, Operatorët ekonomikë, prashikohet shprehimisht se:

1. Kandidatët ose ofertuesit mund të jenë persona fizikë ose juridikë.

2. Grupe operatorësh ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm sipas parashikimeve në rregullat e prokurimit publik. Autoriteti ose enti kontraktor nuk duhet t’i kërkojë një formë të veçantë ligjore bashkimit të shoqërive, për qëllim të dorëzimit të ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje.

Autoritetet ose entet kontraktore mund t’u kërkojnë grupeve të operatorëve ekonomikë që të marrin një formë ligjore specifike, pasi të jenë shpallur fitues, nëse vlerësohet e nevojshme për realizimin e kontratës. Në çdo rast, ky kusht duhet t’u bëhet i ditur operatorëve ekonomikë në dokumentet e tenderit për ekzekutimin e kënaqshëm të kontratës.

3. Rregullat për mënyrën e plotësimit të kriterëve nga grupet e operatorëve ekonomikë në një procedurë prokurimi përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.

NJËSIA E PROKURIMIT